



Nora e Kelmendit


BOTIMET
TOENA
TIRANE

CITTA' di CHIERI
CONSIGLIERE COMUNALE
Vincenzo Cucci

ODHISE K. GRILLO

Nora e Kelmendit rend nëpër shekuj...

Ilustrimet:
Vehap Kokalari



BOTIMET TOENA
Tiranë 2000



Disa shekuj më parë, në Selcë të Kelmendit na paska jetuar Vok Mirash Uci me të shoqen, Hanën. Ata kishin mbetur pa asnje fëmijë, dhe, dy vëllezërët Kola dhe Pjetri, kishin rënë në fushën e luftës kundër pushtuesve osmanë. Si kaluan dy-tre vjetë, Hana na lindi një vajzë si yll e si Zanë, aq e bukur ishte. Mirëpo nuk ia mbushi syrin të atit pasi ai donte djalë e jo vajzë, se “djemtë janë për luftë, e jo vajzat” – thoshte Voku.

Nuk kaluan shumë ditë dhe Voku e mori fshehurazi natën vajzën pesëditëshe dhe shkoi e la te burimi ku merrte ujë familja e Sokolëve. Aty vogëlushja ia dha vajit me të madhe sa e dëgjoi edhe Mrikë Sokoli në kullën e vet. Iu dhimbis në shpirt fëmija që qante dhe doli me vrap e shkoi te burimi. E mori vogëlushen në duar dhe tha me vete:

“Kush vallë e ka lënë në mes të rrugës në këtë dimër e acar këtë yll të këputur?”

Dhe nuk e bëri të gjatë: e çoi në kullën e vet, e ngrohu në zjarr e në gji dhe i dha frymë nga fryma e vet... Kur erdhi i shoqi, Sokoli, menjëherë i tregoi përfatim e vogëlushes dhe vendosën ta mbanin e ta rritnin vetë.





Kur u rrit e u bë shtatë vjeçë, jetimja që i vunë emrin Nora, nisi të shkonte bashkë me shokët e shoqet moshatarë e më të mëdhenj nëpër pllaja e lugina për të kullotur bagëtinë. Të gjitha vajzat luanin bashkë, ndërsa Nora luante me djemtë. Prej tyre mësoi shumë e shumë lodra luftarake dhe shpesh i vinte poshtë moshatarët e vet, aq e fortë dhe e zgjuar ishte.

"Kush vallë e ka lënë në mes të rrugës në këtë dimër e acar këtë yll të këputur?"

Kur e pa se Nora u pëngatit mirë e mirë dhe e zotëroi artin luftarak, i tha fëmijët në Shkodër e më shkentët e tjerë. Shkodra është një qytet i vjetër, i cili ka radojnë kulturën e vjetër shqiptare.

Si kaluan edhe disa vjet, Nora i tha një ditë Mrikës, të cilën e donte si nënë:

- Nanë, unë dua të bëhem luftëtare, që të luftoj për lirinë, si axhë Nika.

Sa u kthyte Nika në shtëpi, Mrika i tregoi të shoqit se kështu e kështu më ka thënë Nora. Sa e dëgjoi, ai pranoi ta stërviste e ta mësonte Norën për t'u bërë luftëtare, se me trupin e forcën që kishte ajo dukej si djalë e jo si vajzë.





Kështu erdhi një ditë që Nora i përdorte pushkën e shpatën më mirë se djemtë dhe me lodrat e mundjes e të shkathësisë gjithnjë dilte fitimtare.

Kur e pa se Nora u përgatit mirë e mirë dhe e zotëroi artin luftarak, i tha të zbriste në Shkodër e të shkonte te probatin Shtjefni, i cili ishte i njohur si rrobaqepës dhe i qante veshjet popullore, që t'i qepte një palë rroba nga ato që mbanin trimat e rinj: çakshir, xhamadan, qeleshe e xhokë...





Duke kullotur bagëtinë, Nora ishte miqësuar shumë me një djalë të ri, të pashëm e trim që i kishte të rrallë shokët. Atë e quanin Martin Pëllumbi. Djaloshi e donte me gjithë shpirt Norën dhe i tha që ta lidhnin bashkë jetën. Mirëpo Nora nuk pranoi. Ajo iu përgjigj Martinit:

- Tani s'është koha për martesë, do ta shtyjmë për më vonë, kur të fitojmë lirinë.

Një ditë, Vokun, babanë e saj që e kishte braktisur, e kishin rrrethuar disa osmanë dhe e kishin vënë në mes. Voku luftonte me të katër me sa fuqi që kishte, po në një çast i rrëshqiti këmba dhe osmanët u hodhën mbi të. Nora, që u ndodh aty afër me bagëti, u sul si skifteri mbi shpendët dhe ua këputi kokën të katër osmanëve sa të hapësh e të mbyllësh sytë. Kështu shpëtoi Voku pa asnje plagë dhe e pyeti djaloshin:

- Cili je ti, o trim, që më shpëtovet jetën?

Nora buzëqeshi dhe iu përgjigj:

- Një luftëtar jam, o Vok Mirash Uci. Emrin do ta mësosh më vonë...

Dhe u zhduk nëpër shkorrete.

Kur morën vesh për trimërinë e Norës, gjithë bashkëfshatarët e kelmendasit pyesin njëri-tjetrin.

- Cili është ky trim, që të merr gjak në vetull?

Po askush nuk dinte të kthente përgjigje, se Mrikë Sokoli, me të shoqin, Nikën, e mbanin të fshehtën thellë në gji.





Në atë kohë në Kelmend sulltani kishte dërguar një ushtri prej tridhjetë mijë ushtarësh, të drejtuar nga gjenerali Vuçi pasha, për të nënshtuar krahinën që nuk e kishte ulur kokën kurrë dhe e kishte mbrojtur lirinë me pushkë e shpatë në dorë. Sulltani i kishte premtuar gjeneralit të vet, se, po të nënshtonte Kelmendin, do ta bënte ministër, prandaj Vuçi pasha shkonte me jatagan e urë në dorë fshat më fshat e shtëpi më shtëpi, duke vrarë e duke prerë në të katër anët. Mirëpo nuk po i nënshtonte dot malësorët.

Atëherë kurdisi një drakulak apo një djallëzi. U bëri thirrje malësorëve dhe u premtoi se po të pushonin luftën do t'ua ngrinte të reja të gjitha kullat dhe vathat do t'ua mbushte dingazi me bagëti. Veç këtyre, që të bindeshin edhe më tepër malësorët, ai kërkonte dorën e Norës së Kelmendit për grua... (Kushedi nga e kishte zbuluar këtë të vërtetë, që e dinin pak njerëz. Me siguri ndonjë spiun, se të tillë ka patur e do të ketë përherë. Ata janë puthadorë e puthakëmbës...)

Sa e morën vesh malësorët kurthin e Vuçi pashës, u mblodhën në kuvend dhe dhanë fjalën e besën të mos e pranonin ftesën e gjeneralit hileqar e egërshan. Folën të gjithë në kuvend dhe përgjigjen ia dhanë me letër Vuçi pashës. Në kuvend foli edhe djaloshi trim e i panjohur që kishte bërë gjithato trimërrira anembanë Kelmendit, që kishte dërguar në atë botë sa e sa osmanë dhe që i kishte shpëtuar jetën Vok Mirash Ucit. Ai kishte thënë:

- Do të shkoj vetë te Vuçi pasha, që t'i jap dy përgjigje: për paqen dhe për nusen që kërkon.

Malësorët e lutën të mos shkonte, po ku dëgjonte Nora e Kelmendit. Ajo shkoi sakaq në shtëpinë e Nikës e të Hanës, që e rritën si bijën e vet, u vesh nuse dhe u kthyte në kuvend e tha:

- Do të shkoj se unë jam Nora e Vok Mirash Ucit, - dhe pa pritur përgjigje bëri poshtë kodrës e ra në Zall të Bruzit, aty ku kishte ngritur taborrin gjenerali Vuçi pasha.





As lutjet e babait të vet, Vokut që u trondit kur mori vesh se e kishte gjallë
të bijën e as lutjet e Martin Pëllumbit nuk e bindën.



Sa e pa Vuçi pasha të futet në shtatoren e vet urdhëroi:

- Qysh sot të bëjmë dasmën më të madhe që ka parë malësia dhe në Kelmend të mos preket asnjë njeri, asnjë kullë e asnjë pronë, asnjë lule...

Këtë ua jep peshqesh nusja ime.

- Ma kadalë, o gjeneral, të them edhe unë fjalën time. Erdha këtu pa krushq e krushka, nuk vura vellon e nusërisë dhe nuk shtinë me pushkë sipas zakonit tonë. Unë s'kam ardhur për t'u bërë nuse, po kam ardhur të të martoj ty me varrin!





Dhe sa të hapësh e të mbyllësh sytë nxorri shishin nga pëqiri dhe ia nguli Vuçi pashës në zemër. Ai u plandos përtokë pa frymë dhe i perëndoi sytë...

Tre oficerët që ndodheshin në shatore deshën të ikin,
por dy prej tyre hëngren dhe nga shishi i Norës. Vetëm i
treti mundi t'ia mbathë nga sytë-këmbët, duke mbajtur
kokën me duar, e duke ulëritur si i marrë:

- Na vranë Vuçi pashën!



Nora hoqi vellon e nusërisë, u vesh me rrobat e luftëtarit, të cilat i kishte në hejbet që solli me vete, rrëmbeu dy jataganë nga të vrarët dhe rendi për t'u bashkuar me malësorët që po prisnin shenjën e saj. Pa hedhur ende shaminë e kuqe në tokë Nora, trimat e Kelmendit u turrën poshtë si ortiqe dhe ranë mbi osmanët e s'lanë asnje të gjallë.

Osmanët që e ndoqën nga pas Norën hëngren dhé, po edhe ajo mori shumë plagë në ballë e në gjoks dhe ra e puthi tokën. Ende pa dhënë shpirt pranë saj u gjend Vok Mirash Uci me lot në sy e pas tij edhe Martin Pëllumbi, që qante si fëmijë. Ata i lanë plagët me ujët e gurrës që rridhët aty afër, i dhanë zemër, e puthën në sy e në ballë dhe vazhdimisht i thoshin:

- Mbaju, moj burneshë!

Nora përpëlistë sytë dhe në çastet e fundit me buzën që i dridhej tha:

- Po shkoj, o atë... Po shkoj, o Martin. Po shkoj si bijë e Selcës, e Kelmendit dhe e Arbërisë.

Kur po jepte frymën e fundit erdhën edhe prindët e saj të dytë: Nikë Sokoli e Mrikë Sokoli, që e deshën më shumë se fëmijët e vet.

- Mbaju, moj sokoleshë! - i thanë.

- Shkoj e lumtur se besoj që ju kam nderuar të gjithëve, - mundi të thoshte dhe e puthi tokën e saj të dashur për herë të fundit.

Ajo iku duke lënë pas trimërinë dhe këngët që u ngritën për të brezpasbrezi, të cilat na e sollën heroizmin e saj gjer në ditët tona, e do ta çojnë edhe më tej, nëpër shekuj e mijëvjeçarë.



NORA E KELMENDIT

Autor: Odhise Grillo

Piktor: Vehap Kokalari

Përkujdesja grafike: Irena Toçi

Janë në qarkullim nga e njëjta kolanë:

SKËNDERBEU

BESA E SHQIPTARIT

DY BATOT DHE ZANA E ILIRISË

MARO KONDA, TRIMËRESHË!

TRIM MBI TRIMA, GJERGJ ELEZ ALIA!

PRITE, PRITE AZEM GALICËN!

KAPEDAN ÇELO PICARI

KËSHTJELLA E ROZAFATIT

PO KU JE ADEM JASHARI?!

KOSTANDINI DHE DHOQINA

OSO KUKA NË KULLË T'BAROTIT

ZANAT E MALIT DHE FUQIA E MUJIT

LEGJENDA E NJË SHKËMBI

BILBILENJTË TREMBËDHJETË

ZEMRA E NËNËS

NORA E KELMENDIT

LULE, O ZENEL GJOLEKA!

PIRROJA I EPIRIT

DAMJAN HIMARJOT VETËTIMA

MIC SOKOLI ME SHTATË ZEMRA